



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK**

---

Numri i lëndës: 2019:137663  
Datë: 01.06.2022  
Numri i dokumentit: 03082723  
CN.nr.09/15

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretarën juridike Azemine Berisha, në lëndën e propozuesit R. (R...) V. nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut kundër kundërpropozusës F.V, e veja e I..., nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, për çështjen jokontestuese Ndarjen e Pasurisë, në seancës gjyqësore me datën 30.05.2022 , në mungesën e palëve ndërgjyqëse, ndërsa më datën 01.06.2022 bëri përpilimin me shkrim të këtij:

**A K T V E N D I M**

I. Propozimi i propozuesit R. V. nga fshati ....., Komuna e Kaçanikut, i ushtruar më datën 16.01.2015, për çështjen jokontestuese Ndarjen e Pasurisë, konsiderohet si i TËRHEQUR.

II. DETYROHET propozuesit që kësaj Gjykate në emër të taksës të i'a paguajnë shumën prej 20.00 €, e cila pages do të bëhet në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të ktijë aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Propozuesi më datën 16.01.2015, në Gjykatën Themelore në Ferizaj Dega në Kaçanik, kanë ushtruar propozim, me të cilin kanë kërkuar që të lejohet Ndarja e Pasurisë, sepse propozuesi dëshiron që ta ndërpres bashkësin dhe që ta kryej ndarjen fizike të pronës së përbashkët , për të cilën propozuesi nuk ka arritur marrveshje me kundër propozuesen të cilët

janë në gjini kusetë. Propozuesi e ka të njohur pjesën e tij, mirpo me qëllim të përcaktimit të saktë të secilës pjesë fizike, është e nevojshme nxjerrja e provës me ekspertizë gjeodezike.

Gjykata për datën 30.05.2022, e ka caktuar seancën gjyqore dhe i ka ftuar palët ndërgjyqse, palët propozuese ftesën e ka pranuar këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga fletkthesa postare e cila gjindet në shkresat e lëndës.

Gjykata propozimin e propozuesit e konsideroj të tërhequr, sepse pala propozuese është ftuar me rregull , mungesën nuk e ka arsyetuar dhe nuk ka kërkuar shtyerjen e shqyrtimit gjyqorë.

Gjykata propozimin e propozuesit e konsideroj si të tërhequr sepse me dispozitën e nenit 12.3 të LPJ-së, është parapar se propozuesi e ka tërhequr propozimin po qëse nuk vjen në seancën e parë për të cilën është thirrur në mënyr të rregullt. Në rastin konkret gjykata e ka ftuar propozuesin në mënyr të rregullt, i njëjti nuk është paraqitur në gjykatë prandaj një propozim të till e ka konsideruar të tërhequr sepse janë plotsuar kushtet ligjore.

Gjykata e detyroi palën propozuese që ta paguajnë shumën prej 20.00€, në emër të taksës për propozim, sepse pala propozuese nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të propozimit, konform udhëzimit administrativ 01-2017.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

#### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.62/13 prej datës 30.05.2022

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këti aktvendimi mundë të paraqitet ankes në afat prej 7 ditve, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelin të Kosovosë me seli në Prishtinë ,ankesa paraqitet në kopje të mjaftushme.